



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHETËRORE**

LËNDA:

**GJUHA ANGLEZE
(Gjuha e huaj e parë)**

Koordinatore: Erifili Hashorva

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHETËTËRORE PËR LËNDËN E GJUHËS ANGLEZE DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë në aspektin tematik dhe gjuhësor e funksional.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në kurrikulat e gjuhës angleze për gjimnazin, duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen, standardet e gjuhëve të huaja, tekstet me të cilat është zhvilluar gjuha angleze në gjimnaz, si edhe përvojën e fituar nga provimet e Maturës Shtetërore të viteve pararendëse. Ky program nxit inspirim dhe sfidë për të gjithë nxënësit dhe i përgatit ata për të ardhmen e tyre. Programi orientues për provimin e Maturës Shtetërore për gjuhën angleze është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve dhe ndryshimet që ata kanë pësuar gjatë tre viteve të gjimnazit.

Synimet e programit

Ky program synon:

- Të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës angleze si lëndë me zgjedhje.
- Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve.
- Të bëjë vlerësimin e njëkohshëm të dy aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy koncepteve bazë, që janë: ***të lexuarit dhe të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.***
- Të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si lëndë me zgjedhje.
- Të vlerësojë të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, aftësinë për të përdorur gjuhën që është e përshtatshme për anglishten standarde (në aspektin e saj morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional).
- Të matë aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme në situatën e komunikimit me shkrim, duke shprehur aftësinë e organizimit dhe të mbrojtjes së ideve me shembuj dhe argumente nga jeta e nxënësve.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Për përdorimin e këtij programi, mësuesi të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato.

Kur flitet për tematikën kryesore në program (p.sh., "Life of famous people"), kjo nuk do të thotë që në provim do të ketë pasazhe nga mësimet që ka në libër (p.sh., David Copperfield, Jony Deep etc.). Në provim mund të dalë jeta e një figure tjetër të shquar në atë fushë. Kështu që mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të kenë njohuri dhe bagazh të konsiderueshëm leksikor për temat që janë të përfshira në program (sports and entertainment, food, health and safety, travel time, environmental issues, modern living etc.).

Për sa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore (passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses and their combination in compound sentences, adverbs and adjectives comparisons, connectors etc.), duke dalë nga konteksti i mësimave ku këto probleme trajtohen. Mësuesi t'i vëre theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë *sentence transformation, error correction* etj.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme, duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi të jetë i përgatitur kryesisht për këto funksione gjuhësore:

- expressing their interests
- talking about different fields of arts
- contrasting ideas or comparing their ideas with others' ones
- recommending places
- making assumptions and suggestions (proposals, comments).

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë me të tëra elementet forma të ndryshme eseje ose kompozimi joletrar. Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore, dhe paragrafët në një njësi të unifikuar (ese ose thjesht kompozim). Gjithashtu, mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tyre në një tekst koherent.

2. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS NË GJUHËN ANGLEZE (KURRIKULA BËRTHAMË)

Nxënësi që i nënshtrohet provimit të Maturës në gjuhën angleze duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për sa më poshtë vijon:

2.1 Reading comprehension (Të lexuarit dhe të kuptuarit)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur, mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose joletrare dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste për të gjetur informacionin e kërkuar; për të mbledhur informacionet që i kërkohen nga pjesë të ndryshme të një teksti, apo tekste të ndryshme, për të përmbushur një detyrë apo kërkesë të caktuar.

Më poshtë po radhisim disa aspekte të leximit:

- Marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Paraqitja e elementeve provuese që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.
- Thellimi në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës.
- Zhvillimi i aftësisë krijuese dhe interpretuese dhe paraqitja e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Kuptimi global i tekstit.
- Kuptimi i thelluar: gjetja e të pashprehurës ose të nënkuptuarës, qëndrimi i autorit etj.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.
- Gjetja e fjalëve referuese.
- Zgjidhja e ushtrimeve leksikore dhe gramatikore rreth tekstit.

2.2 Writing (Të shprehurit me shkrim)

Në provimin e Maturës, nxënësi të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë të gjerë temash, duke i lidhur elementet në mënyrë lineare, të jetë në gjendje të bëjë përshkrime të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar, të tregojë një histori, të shkruajë ese mbi tema të ndryshme, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, të bëjë komentin e një filmi qartë, të shkruajë një informacion, duke u nisur nga shënimet e marra etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej 150-200 fjalësh, ku të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm, duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose që nuk ka lidhje me të. Nxënësi do të vlerësohet për përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore dhe strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- Të shprehurit me shkrim në formën e një eseje për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar në librat e tre viteve (argumentative essays giving for-and-against opinion and solutions to problems).
- Një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (short letters, application or recommendation letters, summaries of texts, reports, reviews and short articles).
- Lidhjen në mënyrë logjike të informacioneve nga burime të ndryshme.
- Shprehjen e pikëpamjeve në formë të argumentuar.
- Përdorimin e një repertori të gjerë leksikor.
- Komente me shkrim për probleme të ndryshme (stories, descriptions of people, places, events and objects).

2.3 The use of english (Përdorimi i gjuhës)

Në këtë program, njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë gjatë tre viteve të gjimnazit janë të dhëna përmes **fushës tematike** të mëposhtme, e cila është e ndarë në linja dhe nënlinja, sipas tematikës së zhvilluar në gjimnaz, dhe përmes **elementeve gramatikore**, që zhvillohen në mënyrë spirale gjatë tre viteve të gjimnazit dhe jepen të detajuara në program.

Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit, janë dhënë përmes **akteve dhe funksioneve komunikative**. Ato tregojnë se cilat janë shprehitë kryesore që një nxënës ka fituar përmes realizimit të programit të gjimnazit dhe që është i aftë të shprehë.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo fushë

Reading and comprehension (Të lexuarit dhe të kuptuarit)

- Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit.
- Ushtrime me përzgjedhje fjalësh ose frazash.
- Plotësimi i vendit bosh me informacionin e duhur (Sentence or phrase completion).
- Ushtrime me përgjigje po/jo.
- Ushtrime me e vërtetë/e rreme (True or False).
- Ushtrime me disa alternativa (Multiple Choice - përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna).
- Ushtrime ku kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Ushtrime ku kërkohet reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve (Arrangement of paragraphs).
- Ushtrime ku i kërkohet paraqitja e elementeve provuese, që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.
- Ushtrime ku kërkohet thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Ushtrime ku kërkohet formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës.
- Ushtrime ku kërkohet zhvillimi i aftësisë krijuese dhe interpretuese dhe paraqitja e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.

Writing (Të shkruarit)

- Shkrimi i një *e-mail*-i, ku i tregohet një miku rreth një përvoje që ka lënë mbresa.
- Përmbledhje e një filmi, libri ose historie.
- Aplikime ose rekomandime për një punë *part-time*.
- Shkrimi i një eseje përshkruese ose argumentuese me tërë fazat e ndërtimit të saj.
- Raporte ku shprehet një vlerësim ose një propozim.
- Shprehja e mendimit rreth një çështjeje të caktuar.

Use of english (Grammar and vocabulary) - Përdorimi i gjuhës

- Ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një fjale me një të ngjashmen e saj.
- Ushtrime transformimi, shprehja e një fjalie me një strukturë tjetër, por duke ruajtur kuptimin e fjalisë.
- Ushtrime me shumë zgjedhje/alternativa (Multiple Choice).
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh, vendosja e fjalës së duhur.
- Ushtrime me ndërtim fjalish.
- Ushtrime me gjetje dhe korrigjime gabimesh, bashkim i funksionit me strukturën përkatëse etj.
- Matching.

Struktura e provimit në përqindje

Aspektet gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Reading and comprehension Të Kuptuarit e një teksti të shkruar (letrar ose joletrar)	30%
Use of english (Grammar and Vocabulary) Përdorimi i Gjuhës (Gramatika dhe leksiku)	40%
Writing Të Shkruarit (ese ose krijim, një letër, kërkesë, përshkrim, artikull, përmbledhje etj.)	30%

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Kjo rubrikë e programit grupon linjat kryesore, si edhe nënlinjat, të cilat janë të përbashkëta për mësimin e gjuhës së huaj. Ato reflektojnë interesat dhe motivimin e nxënësve dhe përfshijnë gjithë sferën e marrëdhënieve *familje-shoqëri-nxënës*; sferën publike dhe sferën profesionale, si edhe aspektin kulturor e qytetërimin.

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë tre viteve të gjimnazit, si edhe në tekstet shkollore për gjuhën angleze. Tematika e mëposhtme, e

parashikuar për provimin e Maturës, përfshin temat bazë (sipas kurrikules) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formuluar në mënyrë përgjithësuese e jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri të cilat janë zhvilluar përmes mësimëve.

Tematika (Topics)

- Personal identification
- Home and Family
- Education, School
- Work & Business
- Culture, Civilization
- Science, Technology
- Leisure Activities
- Holidays, Travelling
- The Human Body, Health
- Shopping
- Food and Drink
- Public Services
- Weather, Climate, Plants & Animals
- Sociopolitical Issues
- Nature and the Environment
- Language.

Leksiku

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme, aktet gjuhësore, si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për t'u përballuar me sukses dhe për t'u shprehur me saktësi dhe lirshëm me shkrim.

Aktet dhe funksionet komunikative

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, që shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikative japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit:

- Expressing interests on something
- Expressing and eliciting preferences
- Expressing obligation, permission and prohibition
- Giving personal information or advice to someone
- Expressing opinions; agreeing, or disagreeing
- Suggesting, and taking a decision
- Asking about/recommending places
- Expressing possibility, probability, certainty
- Expressing similarities/differences, and contrasts
- Stating hypotheses, making assumptions and suggestions
- Expressing concern, repeating and confirming.

Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore me gojë dhe me shkrim, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara gjatë tre viteve të gjimnazit:

- **Verb Tenses:**
Present Tenses, Past Tenses, Future Tenses, Perfect Tenses, Continuous Tenses
- **Gerund and Infinitive Verb Patterns:**
(She hates washing up. The teacher asked me to revise the topic once again.
- **Reported Speech** (positive, interrogative and imperative forms)
- **Active and Passive Voice:** (present, past, future, perfect)
- **Conditionals:** (0, 1st, 2nd, and 3rd, verb tenses and their combinations in conditional sentences)

- **Modal Verbs** (may, might, should, have to, must, could)
- **Adjectives** (comparison degrees, and different ways of comparisons)
Adjective + preposition combinations
- **Prepositions and Idiomatic Prepositional Expressions, and Phrasal Verbs**
- **Adverbs & Adverbial Clauses** (purpose, time, reason, concession, manner, place)
- **Connectors** (above all, such as, then, therefore, whereas, instead, furthermore, however, even so, etc.).

Note to students:

You must think about the language you want to use. It is not enough just to memorize lists of expressions or to memorise the texts from your coursebook. You need to be able to adapt your knowledge to the situation. Language is a creative process.

If you have worked steadily and sensibly during the course then the ‘Matura Exam’ should come as a surprise to you.